



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2020:032633

Datë: 30.09.2024

Numri i dokumentit: 06232449

C.nr.584/2020

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, përmes gjyqtares Mevlide Shabani, me bashkëpunëtoren profesionale Adelina Shabani, në çështjen juridike kontestimore të paditësit N. N., nga fshati L. E., Komuna e Gjilanit, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson av. V. I., nga Prishtina, Rr."P.A., p.n- H., ndaj të paditurës Kompania e Sigurimeve "S...", me seli në Prishtinë, Rr."S. V."-Pallati i Kuq, hyrja "...", të cilën sipas autorizimit e përfaqëson juristi R. R., me objekt kontesti kompensimi i dëmit material dhe jomaterial, pas mbajtjes së seancës për shqyrtim kryesor e publik, më datë 23.09.2024 dhe pranimit të shpjegimeve përfundimtare, mori, ndërsa më datën 27.09.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I. Aprovohet pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësit N. N. nga fshati L. i E., Komuna e Gjilanit, dhe detyrohet e paditura Kompania e Sigurimit "S...", me seli në Prishtinë që paditësit në emër të kompensimit të dëmit material dhe jomaterial nga baza e autopërgjegjësive që ka pësuar paditësi nga lëndimet e marra nga aksidenti i trafikut të datës 22.12.2019, t'ia paguajnë shumat e specifikuara, ashtu që:

A. Në emër të kompensimit të dëmit material, t'ia paguaj shumat e specifikuara më poshtë:

- Në emër të ndihmës dhe kujdesit të personit të tretë, shumën prej 375.00 €;
- Në emër të ushqimit të përforcuar, shumën prej 300 €, dhe
- Në emër të shpenzimeve të mjekimit, shumën prej 86.00 €.

Të tri këto me kamatë ligjore prej 8 % nga data e paraqitjes së padisë më 02.03.2020, e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.

B. Në emër të kompensimit të dëmit jomaterial, t'ia paguaj shumat e specifikuara si më poshtë:

- Në emër të dhimbjeve fizike të të gjitha intenziteteve, shumën prej 1,500.00 €;
- Në emër të frikës të të gjitha llojeve, shumën prej 1,000.00 €
- Në emër të dhimbjeve shpirtërore për dëmitimit të pamjes së jashtme (shëmtimit), shumën prej 3,000.00 €.

Të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8 % duke filluar nga data 27.09.2024 si datë e nxjerrjes së aktgjykimit e deri në pagesën definitive, në afat prej 15 ditësh pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.

II. Pjesa tjetër e kërkesëpadsisë së paditësit N. N., për kompensimin e dëmit material dhe jomaterial, mbi shumat e aprovuara sikurse në dispozitivin nën pikën I të këtij aktgjykimi, refuzohet si e pa bazuar, edhe atë: shuma prej 500.00 € në emër të dhimbjeve fizike për të gjitha intenzitetet; shuma prej 1,000.00 € në emër të frikës për të gjitha llojet; si dhe shuma prej 1,000.00 € në emër të dëmitimit të pamjes së jashtme (shëmtimit).

III. OBLIGOHET e padituria Kompania e Sigurimeve “S.” me seli në Prishtinë, që paditësit N. N., nga fshati L. i E., Komuna e Gjilanit, t’ia paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 717.00 euro, në afat prej 15 ditë, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.

A r s y e t i m

Pretendimet e palëve

Fillimisht paditësi më datë 02.03.2020, përmes të autorizuarit të tij ka parashtruar padi ndaj të paditurës Kompanisë së Sigurimit “S...”, për kompensimin e dëmit material dhe jomaterial.

I autorizuari i paditësit në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 23.09.2024, ka bërë precizimin e kërkesëpadsisë ashtu që i ka propozuar gjykatës që aprovoj kërkesëpadsinë paditësit dhe të detyroj të paditurën kompensimin e dëmit jomaterial edhe atë:

- Në emër të dhimbjes fizike shumën prej 2,000.00 euro
- Për përjetimin e frikës në të gjitha format shumën prej 2,000.00 euro
- Për përkujdesjen e personit të terë për 25 ditë shumën prej 375.00 euro
- Për ushqimin e përforcuar për 20 ditë shumën prej 300.00 euro
- Shpenzimet materiale sipas kuponëve në shumë prej 86.00 euro.

Gjykata me aktvendimin e saj procedural të marrë në seancën përgatitorë të datës 23.09.2024, lejuar precizimin e paditësi në mënyrën e lartshënuar.

Paditësi N. N. nga fshati L. i E., komuna e Gjilanit, përmes të autorizuarit të tij av. V. I., ka theksuar se me datë 22.12.2019, rreth orës 10:30, ka ndodhur aksident trafiku, në vendin dhe mënyrën siç është përshkruar në raportin e aksidentit. Tutje kanë theksuar se deri te aksidenti ka ardhur atëherë kur njësia “A”, ishte duke lëvizur në aksin rrugor Prishtinë- Gjilan, me të arritur në fshatin Bresalc, tek lagja e “Rexhepovitëve”, duke mos e përshtatur shpejtësinë e automjetit të tij me kushtet e rrugës – që të mund të arrij të ndal automjetin para pengesave në rrugë për të mos e goditur mbrapa veturën e tij, dredhon majtas duke kaluar në shiritin e majtë kalon jashtë rrugës e me këtë në mënyrë frontale ndeshet me veturën “B” e cila ishte duke lëvizur në drejtim të kundërt, me ç’rast shkakton aksident trafiku me dëme të konsiderueshme materiale në dy veturat dhe lëndime trupore paditësit. Më tutje ka shtuar se pas administrimit të

provave me pa mëdyshje është vërtetuar bazeshmëria e kërkesëpadisë së paditësit ashtu që i ka propozuar gjykatës që të njëjtën ta aprovoj në tersi si të bazuar dhe ta obligoj të paditurën që paditësit t'ia kompensoj dëmin material dhe jomaterial të shkaktuar me aksidentin e datës 22.12.2019, me kamatë ligjore prej 8%, duke llogaritur nga data e ushtrimit të padisë .

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar në mënyrë të specifikuar edhe atë: në emër të përpilimit të padisë, shumën prej 104.00 euro; në emër të dy seancave gjyqësore 270.40 euro , në emër të ekspertizave mjekësore shumën prej 302.00 euro dhe në emër të taksës gjyqësore, shumën prej 41.00 euro apo në shumë të përgjithshme prej 717.40 euro.

E paditura e parë, përmes të autorizuarit të tij, ka deklaruar se mbetet pranë përgjigjes në padi dhe thëniet e bëra nga seancat gjyqësore duke deklaruar e kundërshtojnë pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit për sa i perkat lartësisë së saj. Më tutje ka shtuar se e paditura pas pranimit të kërkesës për kompensimin e dëmit ka angazhuar cenzorin e kompanisë i cili kishte konstatuar se paditësi me rastin e aksidentit kishte pësuar lëndime të lehta trupore, fakt i cili edhe është vërtetuar me ekspertizën mjekësorë të 04.07.2024, andaj edhe shumat e kërkuara nga ana e paditësit i ka konsideruar të larta, andaj bazuar nga këto i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditësit ta aprovoj pjesërisht si të bazuar.

Gjendja faktike e vërtetuar

Gjykata me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në këtë çështje juridike kontestimore, ka administruar provat materiale dhe atë: Raporti i aksidentit me numër të rastit 2019-CR-....., i datës 22.12.2019, së bashku me skicën nga vendi i ngjarjes; Raporti nga qendra emergjente të përgjithshëm në Gjilan me numër i datës 22.12.2019, si dhe raportet tjera raportet tjera së bashku me kuponat fiskal që përfshijnë shumën prej 86 euro; ekspertiza mjekësore e ekspertes N. M. psikiatre dhe Dr.H. G. ortoped e datës 04.07.2024

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqës dhe provave të lartcekura, në kuptimin e nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe ka gjetur se:

Kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, në këtë çështje kontestimore nuk ka qenë kontestues në mes të palëve ndërgjyqëse fakti se në muajin dhjetor 2019 ka ndodhur një aksident. Po ashtu, gjykata vlerëson se në rastin konkret në mes të palëve ndërgjyqëse kontestuese ishte lartësia e kërkesëpadisë.

Baza ligjore

Gjykata, me rastin e vendosjes duke u bazuar në gjendjen faktike të vërtetuar, si dispozita materiale ka aplikuar nenet: 136.parag.1, 137, 140, 159 parag.1, 169. 172,179 183 parag.1 dhe 2 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (në vijim: LMD), si dhe dispozitën e nenit 18 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia. Me nenin 136 parag.1 të LMD-së, është paraparë se “Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij”, po ashtu me nenin 137 të këtij ligji, është

paraparë se “ Dëmi është zvogëlimi i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe pengimi i rritjes së saj (fitimi i humbur), si dhe shkaktimi tjetrit i dhembjes fizike, vuajtjes psikike ose frikës (dëmi jo material)”. Po ashtu, me nenin 140 parashihet se “Fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje ose nga pakujdesia”, kurse sipas nenit 159 parag.1, parashihet se ”Në rast aksidenti nga mjeti motorik në lëvizje që është shkaktuar vetëm për faj të një zotëruesi zbatohen rregullat për përgjegjësinë në bazë të fajit”. Po ashtu, me nenin 169 dhe 172 të po këtij ligji, është paraparë saktë se në rast dëmtimi duhet të bëhet kompensimi i dëmit dhe të bëhet rikthimi në gjendje të mëparshme, e nëse kjo nuk është e mundur të bëhet kompensimi në të holla. Tutje, me nenin 179 të ligjit, është paraparë se kush i shkakton tjetrit lëndim trupor ose ia dëmton shëndetin ka për detyrë të ia shpërblej shpenzimet rreth mjekimit dhe shpenzimet tjera të nevojshme lidhur me këtë si dhe fitimin e humbur për shkak të paaftësisë për punë gjatë kohës së mjekimit. Në qoftë se i lënduari për shkak të paaftësisë së plotë ose të pjesëshme për punë e humb fitimin, ose nevojat janë shtuar vazhdimisht, ose mundësitë e zhvillimit dhe të përparimit të mëtejshëm janë zhdukur ose janë pakësuar, personi përgjegjës ka për detyrë t’i paguajnë të lënduarit rentën e caktuar në të holla, si shpërblim për këtë dëm. Sipas nenit 183 par.1 dhe 2 të po këtij ligji, është parashikuar se për dhembjet e shkaktuara fizike, shpirtërore, për zvogëlim të aktivitetit jetësor, shëmtimit, cenimit të autoritetit, nderit, lirive ose të drejtave të personalitetit, vdekjes së personit të afërm si dhe frikës, gjykata po të konstatojë se rrethanat e rastit e sidomos intensiteti i dhimbjeve dhe i frikës dhe zgjatja e tyre e arsyetojnë këtë, do të gjykojë shpërblimin e drejtë në të holla pavarësisht nga dëmi material. Me rastin e vendosjes mbi kërkesën për shpërblimin e dëmit jo material si dhe për rëndësinë e saj, gjykata do të kujdeset për rëndësinë e cenimit të mirës dhe qëllimit që i shërben ky shpërblim. Me nenin 18 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia, është parashikuar se personi i dëmtuar të cilit i është shkaktuar dëmi brenda territorit të Republikës së Kosovës nga një mjet motorik, pronari i të cilit nuk është i mbuluar nga sigurimi i autopërgjegjësisë, ka të drejtë të kërkojë dëmshpërblimin e dëmit nga Byroja.

Vlerësimi përfundimtar i gjykatës

Gjykata pas vlerësimit të provave të lartcekura, si dhe thënieve palës paditëse të parashtruara në padi dhe gjatë seancave të mbajtura si dhe thënieve e të paditurës të shprehura në përgjigjen në padi dhe gjatë seancave të mbajtura vlerëson se në rastin konkret në mes të palëve ndërgjyqëse nuk qe kontestues fakti se më datën 22.12.2019 ka ndodhur një aksident trafiku, ku nga ky aksident ka pësuar lëndime paditësi nga i siguruari i të paditure. Po ashtu gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk ishte kontestuese në mes të palëve ndërgjyqëse baza juridike e kërkesëpadisë, mirëpo kontestuese në mes të palëve në këtë kontest ishte lartësia e kërkesëpadisë.

Nisur nga një situatë e tillë gjykata për të vërtetuar rrethanën se paditësit kanë pasur lëndime trupore mori për bazë raportin policor të aksidentit, së bashku me skicën nga vendi i ngjarjes, raportin e emergjencës i lëshuar nga Spitali i Përgjithshëm në Gjilan, për paditësit N. N., si dhe raportet tjera nga kontrollet e bëra nga paditësit, raporte këto të lëshuara nga qendrat spitalore të cekura më lartë .

Sipas ekspertizës së punuar nga ekspertët, dr. H. G.-ortoped-traumatolog, si dhe dr. N. M.-psikiatër, kjo ekspertizë e përpiluar pas ekzaminive përkatëse të paditësit, gjykata ka ardhur në përfundim se paditësi N. N., si pasoj e aksidentit ka pësuar lëndime trupore të cilat i ka karakterizuar si lëndime të lehta trupore. Sipas ekspertizës rezulton se natyra e lëndimeve që ka pësuar paditësi në momentin e dëmtimit e poashtu edhe gjatë shërimit paditësi ka pasur këto dhembje fizike: dhimbje me intensitet posaçërisht të rënë në kohëzgjatje prej 20 min; dhimbje me intensitet të rëndë në kohëzgjatje prej 2 ditëve, për shkak të prerjes së indeve, dërmishjes dhe shtypjes së muskujve të afektuar, deri në marrjen e terapisë kundër dhembjes e që kemi raste ku mund të shfaqen kohë pas kohe nga edema dhe gjakmbledhje e mundshme për 48-72 h e para; dhembje të intensitetit të mesëm në kohëzgjatje prej 21 ditë, kohë e mjaftueshme për fillimin e absorbimit të edemave dhe gjakmbledhjeve të mundshme e që llogaritet si kohë e rifillimit të konsolidimit dhe rivitalizimi i indeve të buta,, të cilat mund të jenë prekur nga shtypja apo dërmishja e indeve; dhimbje e intensitetit të lehtë në kohëzgjatje prej 50 ditësh, kohë për të cilën mund të rikuperohen lëndimet e kësaj natyre sipas të dhënave anamnestike, i njëjti ndien dhimbje akoma që manifestohen me dhimbje të kohëpaskohshme sidomos me ndryshimet klimatike dhe sforcimet fizike; shëmtim trupor i shkallës së mesme me ciktrice ne vetull dhe ballë të dukshme nga distanca; ushqimi i përforcuar ka qenë i nevojshëm për 20 ditë nga dita e lëndimit, i pasur me proteina; ndihma e kujdesit nga personi i tretë në kohëzgjatje prej 25 ditësh në ndihmë për të gjitha aktivitetet jetësore, kujdes i huaj e ndihmë në përgatitje dhe ofrim të ushqimit mbajtje të higjienës personale dhe veshmbathjes; rehabilitim klimaterik në kohëzgjatje për 20 ditë, frikë primare në formë të frikës nga vdekja dhe kërcënimi i drejtpërdrejtë për integritetin e tij ka zgjatur disa sekonda; frikë sekondare e intensitetit të lartë që ka zgjatur për 2 ditë, manifestuar në gjendje të reagimit akut ndaj stresit të përjetuar, rikujtimeve të ngjarjes traumatike, anktheve, indisponimit, çrregullimit të gjumit; frikë sekondare e intensitetit të mesëm ka zgjatur për 1 muaj e shoqëruar me ankthe, rikujtime të ngjarjes traumatikr, indisponimit ku gjatë kësaj periudhe paditësi ka kërkuar edhe ndihmë psikiatrike dhe është trajtuar me terapi adekuate dhe kjo ka kaluar në frikë sekondare të intensitetit të ulët e cila ka zgjatur për 3 muaj, e manifestuar me shqetësime gjatë gjumit, indisponim, kokëdhembje të vazhdueshme me nervozë, humbje durimi, iritabilitët, si pasiguri sidomos gjatë pjesëmarrjes në komunikacion

Pos tjerash gjykata në këtë çështje kontestimore ka gjetur se paditësit nga lëndimet e pësuar kanë pasur shpenzime të konsiderueshme dhe se për të njëjtatai i kanë ofruar kësaj gjykate faturat dhe dëshmitë e tjera të lartcekura, të cilat kjo gjykatë i ka administruar në cilësi të provave material, e të cilave ua ka falur besimin e plotë, prandaj edhe vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Përfundimisht, gjykata konsideron se lartësia e aprovuar në emër të kompensimit të dëmit jomaterial dhe material për paditësit është shpërblim real dhe objektiv dhe paraqet një formë të satisfaksionit që paditësi me këto mjete të plotësojnë nevojat dhe të mirat material që përndryshe nuk paraqesin kompensim absolute të dëmit. Me rastin e vendosjes për lartësinë e kërkesëpadisë për të gjitha kategoritë e caktuara të dëmit jomaterial dhe material ka pasur parasysh rëndësinë e shkeljes së të mirës dhe qëllimit të cilit i shërben kompensimi i gjykuar me bindje se kompensimi të jetë satisfaksion për të dëmtuarin, në këtë rast paditësi, duke

ndikuar kështu në zbutjen e pasojave negative që janë paraqitur si pasojë e dëmit në cenimin e vlerave personale të paditësit.

Gjykata sa i përket kërkesëpadisë së paditësit për ushqim të përforcuar dhe ndihmën e personit tjetër, të njëjtat i ka aprovuar pjesërisht sikurse në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, për shkak se nga ekspertiza mjekësore e ekspertit ortoped-traumatolog rezulton se paditësi ka pasur nevojë për ushqim të përforcuar dhe për ndihmën e personit tjetër në periudhat kohore të cekura sikurse në këtë ekspertizë, ndërsa lartësia e aprovuar për ushqim të përforcuar dhe ndihma e personit tjetër është brenda limiteve të praktikës gjyqësore për këto kategori të dëmit. Sipas vlerësimit të kësaj gjykatë edhe pse nga palët ndërgjyqëse nuk janë prezantuar dëshmi me të cilit do të provohej lartësia e kërkesës për këtë formë të kompensimit të dëmit, gjykata konsideron se ushqimi i përforcuar dhe ndihma e personit tjetër zakonisht merret brenda familjes apo edhe në qendrat shëndetësore dhe rëndom, vlera e ushqimit të përforcuar dhe ndihma e personit tjetër nuk provohet me prova materiale, prandaj edhe aprovoi shumat e caktuara për paditësin, e më gjerësisht sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Ndërsa sa i përket pjesës refuzuese, respektivisht shumës mbi shumat e aprovuara, gjykata të njëjtat i refuzoi si të pa bazuara. Mbi bazën e të lartcekurave, gjykata vlerëson se shumat e kërkuara me kërkesëpadi përtej shumave të aprovuara nuk janë reale dhe nuk i përgjigjen shkallës së dëmit të shkaktuar paditësit.

Për kamatën gjykata ka vendosur duke u mbështetur në dispozitën e nenit 382 par.1 dhe 2 të LMD-së.

Gjykata ka vlerësuar edhe theksimet dhe provat e tjera të palëve ndërgjyqëse, por ka gjetur se të njëjtat janë pa ndikim në nxjerrjen e këtij aktgjykimi.

Gjykata sa i përket shpenzimeve të procedurës të kërkuara nga i autorizuari i paditësit ka vendosur në bazë të neneve 450, 453 463 të LPK-së, dhe bazuar në Tarifën e Odës së Avokatëve të Kosovës (TOAK), ashtu që paditësit ia ka njohur shpenzimet e procedurës kontestimore, edhe atë: për ushtrimin e padisë, shumën prej 41.00 €; për taksën gjyqësore, ; shumën prej 104.00 euro në emër të përpilimit të padisë; shumën prej 270.40 për dy seanca të mbajtura si dhe për punën e ekspertëve, përkatësisht ekspertin ortoped-traumatolog, ekspertin ekspertin psikiatër, shumën prej 302.00 €, apo shumën e përgjithshme për të gjitha shpenzimet e procedurës prej 717.40 €.

Nga të cekurat më lartë gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-

C.nr.584/2020, datë 27.09.2024

Gj y q t a r j a,
Mevlide Shabani

Numri i lëndës: 2020:032633
Datë: 30.09.2024
Numri i dokumentit: 06232449

KËSHILLA JURIDIKE – Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimet të tij, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.